

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
RETAIL PARK SH.P.K.
ME SELI NË : GODINA BRUNES SPACE, KATI I 2-TE, PRANE QENDRA TREGTARE TEG, PERBALLE HYRJES
VJOLE RRUGA NACIONALE TIRANE-ELBASAN, FARKE, LUNDER,TIRANE
NIPT L71515042Q

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më **08.03.2023 (dy mijë e njëzet e tre)**, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë **“Retail Park” Sh.p.k.**, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L71515042Q, me adresë në **“Godina Brunos Space, Kati I 2-Te, Prane Qendra Tregtare TEG, Perballe Hyrjes Vjole Rruga Nationale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder,Tirane”**, (më tej referuar si **“Shoqëria”**), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

- **“Balfin-Balkan Finance Investment Group” Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, - e cila zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin-Balkan Finance Investment Group (**“Ortaku i Vetëm”**).

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 **“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”** dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË RETAIL PARK SH.P.K.;

II. TË NDRYSHME;

Duke kaluar në diskutimin e çështjes të Rendit të Ditës, Kryetari parashtron se për nevoja operacionale të Shoqërisë kërkohet financimi i saj me një shumë prej 116,549,999.95 LEK (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e pesë lekë). Financimi do të jepet në formën e kontributit në para në kapitalin e Shoqërisë i cili nga **326,611,340.05 LEK** (treqind e njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet presje zero pesë lekë) do të bëhet **443,161,340 LEK (katërqind e dyzet e tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet leke)**.

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes në Rendin të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOSI

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitali të shoqërisë RETAIL PARK Sh.p.k., (NUIS L71515042Q) me 116,549,999.95 LEK (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e pesë lekë) ("Zmadhimi i Kapitalit");
- B. Zmadhimi i Kapitalit do të nëshkruhet dhe shlyhet tërësisht nga Ortaku i Vetem në para. Kapitali i Shoqërisë pas zmadhimit nga **326,611,340.05** LEK (treqind e njëzet e gjashtë milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet presje zero pesë lekë) do të bëhet **443,161,340 LEK (katërqind e dyzet e tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet lekë)**;
- C. Të autorizojë Administratorin në detyrë të Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim;.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.


Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "RETAIL PARK" Sh.p.k., mbahet në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

* * * * *

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00.

**ASAMBLE E PËRGJITHSME E SHOQËRISË
RETAIL PARK SH.P.K.**

KRYETAR


ZNJ. EDLIRA MUKA



SEKRETAR


ZNJ. EYA VEIZAJ